



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT  
KORÇË

VENDIM  
Nr 52 Datë 25.05.2010


MBI DETAJIMIN E PROGRAMIT TE INVESTIMEVE NE  
INFRASTRUKTUREN RRUGORE PER VITIN 2010-2011

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës «Mbi detajimin e programit të investimeve në infrastrukturën rrugore për vitin 2010-2011», në zbatim të ligjit nr 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", ligjit nr 9936 dt 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», në zbatim të VKB nr. 20 datë 25.03.2010 «Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2010, në zbatim të ligjit nr. 9869 dt. 04.02.2008 «Për huamarrjen e qeverisjes vendore», Udhëzimit nr. 35 datë 05.11.2008 i Ministrisë, si dhe të kontratës së kredisë datë 31.03.2010 midis Bashkisë Korçë dhe Pro Credit Bank Sh.A, vendimit të KRRT të Bashkisë Korçë nr. 16 datë 21.05.2010, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratohet detajimi i programit të investimeve sipas projekteve në infrastrukturën rrugore për vitin 2010-2011 si më poshtë :

<b>Burimet e financimit për investime</b>		<b>2010</b>	<b>2011</b>
Kredi me disbursim 2 vjeçar	100,000	45,000	55,000
Të ardhurat e Bashkisë 2010	53,000	53,000	
Të ardhurat e Bashkisë 2011	66,000		66,000
<b>Totali</b>	<b>219,000</b>	<b>98,000</b>	<b>121,000</b>
<b>Shpenzimet për investime</b>			
• Rikonstruksion Bulevard Republika	37,200	37,200	
• Kësti i kredisë	21,500	5,500	16,000
• Rikonstruksion i shëtitores F.Noli	17,000	2,000	15,000
• Blloqe pallatesh (L.15,16,17/1)	20,000	3,500	16,500
• Sistemime terrenesh rreth banesave kolektive (PIU)	2,000	2,000	
<b>Total</b>	<b>97,700</b>	<b>50,200</b>	<b>47,500</b>



2. Të mos miratohen :

- a) « Rikonstruksion i sheshit perpara Katedrales » me vlerë 25,000 mijë lekë për vitin 2010 dhe 73,500 mijë lekë për vitin 2011, në total 98,500 mijë lekë.
- b) « Rikonstruksion i Bulevard Shën Gjergji – zona pedonale » (kontributi 30%) me vlere 22,800 mijë lekë për vitin 2010.

<b>Total</b>	<b>121,300</b>	<b>47,800</b>	<b>73500</b>
--------------	----------------	---------------	--------------

3. Fondi prej **121,300** mijë lekë (47,800 mije lek per vitin 2010 dhe 73,500 mije lek per vitin 2011), i cili përfshinte financimin e dy projekteve te pamiratuara sipas pikës 2 të këtij vendimi do të detajohet nga Ekzekutivi (duke njoftuar dhe Keshillin Bashkiak) për investime te tjera në infrastrukturën rrugore, të cilat do te përzgjidhen nga lista e prioriteteve të investimeve të miratuara në Këshillin Bashkiak me vendimin nr. 17 datë 12.03.2010 « Për përcaktimin e prioriteteve të investimeve për vitin 2010 », por duke përjashtuar nga kjo përzgjedhje projektet sipas pikës 2 te ketij vendimi « Rikonstruksion i sheshit perpara katedrales , Rikonstruksion Bulevard Shengjergji-zona pedonale ».
4. Të miratojë shpërndarjen e fondit për Institucionin Njësia e Zbatimit të Projekteve (ndërtimi i banesave me qëllim social) (PIU) për sistemime terrenesh rreth banesave kolektive dhe pagesa e kështit të kredisë me këtë strukturë buxhetore:
- |           |    |       |    |             |                      |
|-----------|----|-------|----|-------------|----------------------|
| PAKESOHET | 00 | 04530 | 05 | Art 2310000 | -7,500,000 lekë      |
| SHTOHET   | 00 | 01110 | 05 | Art 6020000 | +5,500,000 lekë      |
| SHTOHET   | 00 | 01110 | 05 | Art 2310000 | +2,000,000 lekë(PIU) |
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Sektori i Prokurimeve, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe hartimit të Projekteve në Infrastrukturë si dhe Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

Kryetari

Gjergji PENDAVINJI

